

UDHËZIM
Nr. 385, datë 13.10.2020

**PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE DHE PROCEDURAVE PËR MARRJEN E
LICENCËS PËR ADMINISTRIMIN KOLEKTIV TË TË DREJTAVE TË AUTORIT,
RIPËRTËRITJEN E SAJ, SI DHE PËRCAKTIMIN E KRITEREVE DHE
PROCEDURAVE PËR PEZULLIMIN DHE HEQJEN E LICENCËS NË ZBATIM TË
LIGJIT NR. 35/2016, DATË 31.3.2016, “PËR TË DREJTAT E AUTORIT DHE TË
DREJTAT E TJERA TË LIDHURA ME TO”**

(Ndryshuar me udhëzimin nr. 472, datë 19.11.2020; nr. 336, datë 10.6.2021)

(I përditësuar)

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës dhe neneve 158 dhe 188, të ligjit nr. 35/2016, datë 31.3.2016, “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”,

UDHËZOJ:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

A. Qëllimi i udhëzimit

Ky udhëzim përcakton kriteret dhe procedurat për marrjen dhe/ose ripërtëritjen e licencës nga Agjencitë e Administrimit Kolektiv (këtej e tutje “AAK”), në zbatim të neneve 133, 134, 135 dhe 159, të ligjit nr. 35/2016 “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”, si dhe kriteret dhe procedurat për rastet e tjera që përbëjnë kusht për pezullimin apo heqjen e licencës së AAK-së.

B. Kriteret për marrjen e licencës si AAK

1. Për të kryer administrimin kolektiv të të drejtave të autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me to, organizata jofitimprurëse, përveç sa parashikuar në nenet 133, 134 dhe 135, të ligjit nr. 35/2016, datë 31.3.2016 “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”, duhet të ketë edhe:

a) disponon një listë të mbajtësve të të drejtave, që kanë dhënë pëlqimin me shkrim për ta autorizuar për administrimin e të drejtave të tyre;

b) dëshmon shprehjen e vullnetit për përfaqësim reciprok me agjencitë e huaja, në gjuhën shqipe;

c) ka kushte të përshtatshme dhe pajisje të teknologjisë së informacionit për të kryer funksionet e saj;

ç) ka ekspertizë dhe shërbim teknik dhe logjistik të përshtatshëm për njohjen e të drejtave të autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me to, në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar;

d) ka ekspertizë profesionale me një punonjës jurist të dokumentuar me dokument punësimi dhe është njohës i të paktën një gjuhe të huaj të vërtetuar me dëshminë përkatëse;

dh) ka ekspertizë profesionale me një punonjës në fushën financiare dhe është njohës i të paktën një gjuhe të huaj të vërtetuar me dëshminë përkatëse;

e) deklaron se gëzon mekanizma të mjaftueshëm lidhur me monitorimin, shpërndarjen dhe pagesën e shpërblimeve, në mënyrë të drejtë dhe transparente, bazuar në përdorimin e veprës së mbrojtur nga e drejta e autorit dhe objekteve të tjera të lidhura me to;

ë) vërteton plotësimin e kriterëve të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, të germës “B”, brenda 6 (gjashtë) muajve pas marrjes së licencës për kategorinë përkatëse të të drejtave të autorit ose të drejtave të tjera të lidhura me to;

f) dokumentacioni i parashikuar në shkronjën “a” dhe “b”, të kësaj pike, do të shoqërohet me lista të plota të titujve të veprave të cilat do të administrohen, jo më shumë se 6 (gjashtë) muaj pas marrjes së licencës për kategorinë përkatëse të të drejtave të autorit ose të drejtave të tjera të lidhura me to;

g) depoziton pagesën e tarifës për aplikim për licencimin të organizatës si AAK, në përputhje me pikën 4, të nenit 157, të ligjit nr. 35/2016 dhe vendimit nr. 33, datë 18.1.2017, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e tarifave për shërbimet e ofruara nga Drejtoria për të Drejtën e Autorit”.

C. Kriteret për ripërtëritjen e licencës së AAK-ve

1. Për ripërtëritjen e licencës, për të kryer administrimin kolektiv të të drejtave të autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me to, AAK-ja, përveç sa parashikuar në nenet 133, 134, 135, 137, të ligjit nr. 35/2016, datë 31.3.2016 “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”, duhet të ketë edhe:

a) disponon kontratat e lidhura me mbajtësit e të drejtave, të cilët i kanë dhënë kompetencat e tyre të përfaqësimit për administrimin e të drejtave të tyre, sipas ligjit nr. 35/2016 “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”. *Këto kontrata do të shoqërohet me lista të plota të titujve të veprave, të cilat do të administrohen;*

b) disponon kontratat për përfaqësim reciprok të nënshkruara me agjencitë e huaja, në gjuhën shqipe; *Vërteton respektimin e marrëdhënieve të reciprocitetit me agjencitë e huaja me të cilat është lidhur marrëveshje/ kontratë përfaqësimi.*

c) garanton mënyrën efektive të funksionimit të brendshëm dhe respektimit të akteve rregulluese;

ç) ka kushte të përshtatshme dhe pajisje të teknologjisë së informacionit për të kryer funksionet e saj;

d) ka ekspertizë dhe shërbim teknik dhe logjistik të përshtatshëm për njohjen e të drejtave të autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me to, në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar;

dh) ka ekspertizë profesionale me një punonjës jurist të vërtetuar me kontratë punësimi. Punonjësi është njohës i të paktën një gjuhe të huaj të vërtetuar me dëshminë përkatëse;

e) ka ekspertizë profesionale me një punonjës në fushën financiare të vërtetuar me kontratë punësimi. Punonjësi është njohës i të paktën një gjuhe të huaj të vërtetuar me dëshminë përkatëse;

ë) dëshmon se ka kryer monitorimin, shpërndarjen dhe pagesën e shpërblimeve në mënyrë të drejtë dhe transparente, bazuar në përdorimin e veprës së mbrojtur nga e drejta e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to;

f) depoziton pagesën e tarifës për aplikim për ripërtëritjen e licencës të organizatave si AAK, në përputhje me nenin 157, të ligjit nr. 35/2016 dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 33, datë 18.1.2017 “Për miratimin e tarifave për shërbimet e ofruara nga Drejtoria për të Drejtën e Autorit”;

g) depoziton raportin dhe bilancin vjetor për performancën e saj në lidhje me mbledhjen, shpërndarjen e shpërblimeve për anëtarët e tyre dhe shpenzimet e kryera në ushtrim të objektit të licencës në përputhje me legjislacionin tatimor në fuqi.

D. Procedura për aplikim për licencë apo ripërtëritje të saj

1. Nëpërmjet një thirrje publike në faqen zyrtare të ministrisë përgjegjëse për të drejtën e autorit, njoftohen të gjitha subjektet që mund të kenë interes për pajisjen me licencë apo ripërtëritje të saj për kategorinë përkatëse për të drejtat e autorit apo të drejtave të tjera të lidhura me to.

2. Subjektet e interesuara dhe AAK-të duhet të paraqesin kërkesën për licencim apo ripërtëritje të licencës për Agjencinë e Administrimit Kolektiv, e cila përmban:

a) kërkesë për shprehje interesi;

b) formularin e aplikimit sipas formatit të miratuar bashkëlidhur këtij udhëzimi;

c) dokumentacionin shoqërues, i cili vërteton përmbushjen e të gjitha kriterëve të përcaktuara në ligjin nr. 35/2016 dhe në shkronjat B dhe C, të kreut I, të këtij udhëzimi;

3. Afati për depozitim e kërkesave dhe plotësimin e plotë të dosjes së aplikimit për licencim ose ripërtëritjen e saj është 30 ditë kalendarike nga data e publikimit të thirrjes në faqen zyrtare të ministrisë përgjegjëse për të drejtën e autorit. *Në çdo rast shtyrja e këtij afati do të bëhet me urdhër të ministrit të Kulturës dhe është i argumentuar.*

4. Dokumentacioni depozitohet pranë protokollit të ministrisë përgjegjëse për të drejtën e autorit.

5. *Ministri përgjegjës për të drejtën e autorit, ngre grupin e punës për shqyrtimin e kërkesave për licencim apo ripërtëritjen të licencës së AAK-ve dhe përcakton afatet për shqyrtimin e dokumentacionit.*

6. Brenda afatit të përcaktuar në urdhrin e ministrit, kryhet shqyrtimin e dokumentacionit dhe i paraqitet ministrit përgjegjës për të drejtën e autorit propozimet sipas parashikimit të shkronjës “ë”, pika 2, e nenit 157, të ligjit nr. 35/2016.

7. Ministri përgjegjës për të drejtën e autorit vendos me urdhër për licencim ose ripërtëritje të licencës së AAK-së.

8. Urdhri i ministrit për licencim apo ripërtëritje të licencës hyn në fuqi menjëherë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

II. PEZULLIMI OSE HEQJA E LICENCËS SË AAK-së

A. Kushtet dhe procedura për pezullimin e licencës së AAK-së

1. Pezullimi i licencës së një AAK-je bëhet në rastet e mëposhtme:

a) moszbatimi i pikave 1 dhe 2, të nenit 153, të ligjit nr. 35/2016, datë 31.3.2016, “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”;

b) mosdhënia e informacionit të kërkuar te ministria përgjegjëse për të drejtën e autorit brenda 10 ditëve pune, në bazë të shkronjës “f”, të pikës 2, të nenit 157, të ligjit nr. 35/2016;

c) moszbatimi i detyrimit të shkronjës “ë”, pika 1 e germës B, të këtij udhëzimi;

2. Procedura e pezullimit të licencës së një AAK-je:

a) në rast se Drejtoria për të Drejtën e Autorit (në vijim “DDA”), kryesisht ose me kërkesë të subjekteve të interesuara, konstaton shkeljet e parashikuara në pikën 1, të këtij kreu, referuar pikës 5, të nenit 159, të ligjit nr. 35/2016, “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”, njofton ministrin përgjegjës për të drejtën e autorit;

b) DDA-ja urdhëron AAK-në për rregullimin e të metave të konstatuara brenda 30 ditëve nga marrja e njoftimit;

c) brenda 30 ditëve nga data e marrjes së njoftimit, AAK-ja vë në dijeni DDA-në për rregullimin e të metave dhe paraqet dokumentacionin provues për masat e marra;

ç) në rastet e mos rregullimit të të metave brenda afatit të parashikuar në shkronjën “b”, pika 2, të germës A, të këtij kreu, DDA-ja menjëherë i propozon ministrit përgjegjës për të drejtën e autorit fillimin e procedurës për pezullim licence;

d) ministri përgjegjës për të drejtën e autorit ngre menjëherë grupin e punës për zhvillimin e procedurës administrative;

dh) grupi i punës zhvillon dhe përfundon procedurën administrative sipas përcaktimeve të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurës Administrative”;

e) *DDA-ja, bazuar në raportin e grupit të punës, në varësi të rrethanave, i propozon ministrit përgjegjës për të drejtat e autorit pezullimin për 6 (gjashtë) muaj të licencës;*

ë) ministri përgjegjës për të drejtën e autorit, bazuar në raportin e DDA-së, urdhëron për pezullim ose jo të licencës së AAK-së;

f) AAK-së ndaj së cilës është marrë masa e pezullimit të licencës humbet të drejtën të ushtrijë funksionet për të cilat është licencuar për periudhën e pezullimit;

g) urdhri i ministrit për pezullimin e licencës hyn në fuqi menjëherë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

B. Kushtet dhe procedura për heqjen e licencës së AAK-së

1. Heqja e licencës së një AAK-je bëhet në rastet e mëposhtme:
 - a) kur konstatohen shkelje të kuadrit ligjor për të drejtën e autorit lidhur me shpenzimet dhe shpërndarjet e shpërblimeve;
 - b) kur AAK-ja përfaqëson titullarët e të drejtave të autorit për kategorinë për të cilën nuk është licencuar;
 - c) kur AAK-ja nuk ka bërë deklarin e të gjitha fakteve materiale të mbajtura të fshehura apo të reja, të cilat mund të përbënin shkak për refuzimin e marrjes së licencës pas aplikimit;
 - ç) kur shkelen parashikimet ligjore të pikës 4, të nenit 133, të ligjit nr. 35/2016.
2. Procedura për heqjen e licencës së një AAK-je është si më poshtë:
 - a) në rast se DDA-ja, kryesisht ose me kërkesë të subjekteve të interesuara, konstaton shkeljet e parashikuara në shkronjën B, pika 1, të këtij kreu, referuar pikës 5, të nenit 159, të ligjit nr. 35/2016, “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”, njofton menjëherë ministrin përgjegjës për të drejtën e autorit;
 - b) DDA-ja urdhëron AAK-në për rregullimin e të metave të konstatuara brenda 30 ditëve nga marrja e njoftimit;
 - c) brenda 30 ditëve AAK-ja vë në dijeni DDA-në për rregullimin e të metave dhe paraqet dokumentacionin provues për masat e marra;
 - ç) në rastet e mos rregullimit të të metave brenda afatit në shkronjës “b”, pika 2, të germës B, të këtij kreu, DDA-ja menjëherë i propozon ministrit përgjegjës për të drejtën e autorit fillimin e procedurës për heqjen e licencës;
 - d) ministri përgjegjës për të drejtën e autorit ngre menjëherë grupin e punës për zhvillimin e procedurës administrative;
 - dh) grupi i punës zhvillon dhe përfundon procedurën administrative sipas përcaktimeve të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurës Administrative”;
 - e) *DDA-ja, bazuar në raportin e grupit të punës, në varësi të rrethanave, i propozon ministrit përgjegjës për të drejtat e autorit heqjen e licencës;*
 - ë) ministri përgjegjës për të drejtën e autorit, bazuar në raportin e DDA-së urdhëron për heqjen ose jo të licencës së AAK-së;
 - f) AAK-së ndaj së cilës është marrë masa e heqjes së licencës humbet të drejtën të ushtrojë funksionet për të cilat është licencuar;
 - g) AAK-ja, ndaj së cilës është marrë masa për heqjen e licencës, humbet të drejtën për aplikim për pajisje me licencë për një periudhë 3-vjeçare (trevjeçare) nga data e hyrjes në fuqi të urdhrit të ministrit;
 - gj) urdhri i ministrit përgjegjës për të drejtën e autorit hyn në fuqi menjëherë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

III. DISPOZITAT KALIMTARE

1. Në rast moslicencimi apo ripërtëritje të licencës, kërkuksi ka të drejtën e ankimit sipas dispozitave të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë.
2. AAK-së së cilës i është pezulluar apo hequr e drejta për të ushtruar veprimtari të administrimit kolektiv, ka të drejtën e ankimit. Ankimi në gjykatë nuk pezullon aktin administrative, përveç kur vendoset ndryshe nga gjykata kompetente.
3. Udhëzimi nr. 5166, datë 20.10.2016 “Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave të tjera shtesë në sqarim të kriterëve të parashikuara në nenin 133, si dhe përcaktimin e kushteve dhe procedurës së marrjes së licencës ose ripërtëritjen e saj, në bazë të nenit 134, të ligjit nr. 35/2016, datë 31.3.2016 “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”, i ministrit të Kulturës shfuqizohet.
4. Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë pas botimit në Fletoren Zyrtare.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS

Formular aplikimi për licencimin e agjencive të administrimit kolektiv për të drejtën e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to

Data e aplikimit _____
data, muaji, viti

Data e dorëzimit _____
data, muaji, viti

1. Emri, _____
(organizatë pa qëllim fitimi, nenet 133, 134, të ligjit nr. 35/2016, “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to” dhe të udhëzimit të ministrit të Kulturës nr. _____, datë _____).

Adresa e selisë së Agjencisë:

- a) Qyteti _____;
- b) Rruga _____;
- c) Tel: _____;
- d) Fax: _____;
- e) *Email*: _____.

2. Përfaqësuesi ligjor i Agjencisë, z./znj. _____.

3. Kategoria e të drejtave të autorit apo të drejtave të tjera të lidhura me to, ku kërkoni të administroni në emër të mbajtësit të të drejtave të autorit/të drejtave të lidhura me to (përshkrimi i kategorisë përkatëse):

- a) _____
- b) _____
- c) _____

4. Vendim regjistrimi në gjykatë, i dalë nga sekretaria gjyqësore:

- a) Nr. _____, datë _____.

5. Statut (bashkëlidhur) i dalë nga sekretaria gjyqësore, sipas vendimit të regjistrimit të gjykatës, sipas kërkesave të ligjit nr. 35/2016, “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to” dhe udhëzimit të ministrit të Kulturës nr. 385, datë 13.10.2020; (objektivat dhe qëllimet, të drejtat e administruara, kategoritë e mbajtësve të të drejtave që Agjencia përfaqëson kriteret për humbjen ose

fitimin e anëtarësisë, të drejtat dhe detyrimet e anëtarëve, rregullat e zgjedhjes dhe funksionimit të organeve drejtuese etj.).

6. Ekstrakt lëshuar nga gjykata për regjistrimin e saj, si OJF, organet drejtuese ekzekutive dhe kolegjiale.

7. Mënyrën e përdorimit të kapitalit ose aseteve të tjera, në rast likuidimi të shoqërisë.

8. Banka/t dhe nr. i llogarisë/ve përkatëse për kryerjen e veprimeve financiare.

9. Drejtori ekzekutiv duhet të jetë shtetas shqiptar apo rezident në Republikën e Shqipërisë.

10. Rregullore e brendshme e dalë nga sekretaria gjyqësore, sipas vendimit të mësipërm të regjistrimit në gjykatë.

11. Administrimi kolektiv i të drejtave është aktiviteti i saj i vetëm, përveç rastit kur veprimtaritë e tjera të saj janë në fushën e artit dhe kulturës.

12. Listë të mbajtësve të të drejtave që kanë dhënë pëlqimin me shkrim për ta autorizuar për administrimin e të drejtave të tyre dhe do të shoqërohen me lista të plota të titujve të veprave të cilat do të administrohen.

13. Dokumentacionin e nevojshëm, në gjuhën shqipe, që dëshmon shprehjen e vullnetit për përfaqësim reciprok me agjencitë e huaja.

14. Dokument provues të kushteve të përshtatshme dhe pajisje të teknologjisë së informacionit për të kryer normalisht funksionet e saj.

15. Dokument provues të ekspertizës dhe shërbimit teknik dhe logjistik të përshtatshëm për njohjen e të drejtave të autorit dhe të të drejtave të tjera të lidhura me to, në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.

16. Dokument provues të ekspertizës profesionale me një punonjës jurist dhe është njohës i të paktën një gjuhe të huaj të vërtetuara me dëshmitë përkatëse.

17. Dokument provues të ekspertizës profesionale me një punonjës në fushën financiare dhe është njohës i të paktën një gjuhe të huaj të vërtetuara me dëshmitë përkatëse.

18. Dokument provues për mekanizma të mjaftueshëm lidhur me mbledhjen shpërndarjen dhe pagesën e shpërblimeve.

19. Për pikat 12 dhe 13 të këtij formulari depozitohet dokumentacioni provues për plotësim të tyre brenda 6 (gjashtë) muaj pas marrjes së licencës për kategorinë përkatëse të të drejtave të autorit ose të drejtave të tjera të lidhura me to.

20. Paga e tarifës për aplikim për licencimin e organizatave si agjenci të administrimit kolektiv, në përputhje me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 33, datë 18.1.2017, “Për miratimin e tarifave për shërbimet e ofruara nga Drejtoria për të Drejtën e Autorit”.



Formular aplikimi për ripërtëritjen e agjencive të administrimit kolektiv për të drejtën e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to.

Data e aplikimit _____
data, muaji, viti

Data e dorëzimit _____
data, muaji, viti

1. Emri i Agjencisë _____
(organizatë pa qëllim fitimi nenet 133, 134, të ligjit nr. 35/2016, “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to” dhe udhëzimit të ministrit të Kulturës nr. _____, datë _____).

Adresa e selisë të Agjencisë:

Qyteti: _____;

Rruga: _____;

Tel: _____;

Fax: _____;

Email _____.

2. Përfaqësuesi ligjor i Agjencisë, z./znj. _____.

3. Vendim regjistrimi në gjykatë, i dalë nga sekretaria gjyqësore:

Nr. _____, datë _____ (i rifreskuar):

4. Ekstrakt lëshuar nga gjykata për regjistrimin e saj si OJF, organet drejtuese ekzekutive dhe kolegjiale.

5. Statut (bashkëlidhur) i dalë nga sekretaria gjyqësore, sipas vendimit të regjistrimit të gjykatës, sipas kërkesave të ligjit nr. 35/2016, “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”, dhe udhëzimit të ministrit të Kulturës nr. 386, datë 13.10.2020; (objektivat dhe qëllimet, të drejtat e administruara, kategoritë e mbajtësve të të drejtave që Agjencia përfaqëson, kriteret për humbjen ose fitimin e anëtarësisë, të drejtat dhe detyrimet e anëtarëve, rregullat e zgjedhjes dhe funksionimit të organeve drejtuese etj.).

6. Kategoria e të drejtave të autorit apo të të drejtave të tjera të lidhura me to që kërkohet të administrohen në emër të mbajtësit të të drejtave të autorit/të drejtave të lidhura me to (përshkrimi i kategorisë përkatëse):

a) _____;

b) _____;

c) _____.

7. Mënyrën e përdorimit të kapitalit ose aseteve të tjera, në rast likuidimi të shoqërisë.

8. Banka/t dhe nr. i llogarisë/ve përkatëse për kryerjen e veprimeve financiare.

9. Drejtori ekzekutiv duhet të jetë shtetas shqiptar apo rezident në Republikën e Shqipërisë.

10. Rregullore e brendshme e Agjencisë (bashkëlidhur) e dalë nga sekretaria gjyqësore, sipas vendimit të mësipërm të regjistrimit në gjykatë.

11. Kontratat e lidhura me mbajtësit e të drejtave të cilët i kanë dhënë kompetencat e tyre të përfaqësimit për administrimin e të drejtave të tyre.

12. Kontrata për përfaqësim reciprok të nënshkruara me agjencitë e huaja në gjuhën shqipe.

13. Administrimi kolektiv i të drejtave është aktiviteti i saj i vetëm, përveç rastit kur veprimtaritë e tjera të saj janë në fushën e artit dhe kulturës.

Po _____ Jo _____

14. Mënyrën e funksionimit të brendshëm dhe e respektimit të akteve rregulluese.
15. Raportimin dhe përmbushjen e detyrave të lëna nga ministria përgjegjëse për të drejtën e autorit.
16. Dokumente provuese për respektimin e marrëdhënieve të reciprocitetit me agjencitë e huaja me të cilat është lidhur marrëveshje/kontratë përfaqësimi.
17. Dokumente provuese për përmbushjen/zbatimin e parashikimeve të ligjit për të drejtën e autorit për ushtrimin e administrimit kolektiv dhe të legjislacionit në fuqi.
18. Dokumente provuese të funksionimit të mekanizmave për mbledhjen dhe shpërndarjen e shpërblimeve kundrejt anëtarëve titullarë të të drejtave.
19. Kushte të përshtatshme me pajisje të teknologjisë së informacionit për të kryer normalisht funksionet e saj;
20. Ekspertizë dhe shërbim teknik dhe logjistik të përshtatshëm për njohjen e të drejtave të autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me to, në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.
21. Ekspertizën profesionale me të paktën një punonjës jurist dhe është njohës i të paktën një gjuhe të huaj, të vërtetuara me dëshmitë përkatëse;
22. Dokument provues të ekspertizës profesionale me një punonjës në fushën financiare dhe është njohës i të paktën një gjuhe të huaj, të vërtetuara me dëshmitë përkatëse.
23. Dokumentacion, dëshmi për punonjësit që do të jenë pjesë administrative e AAK-së, që vërteton kualifikimet e tyre profesionale, përvojën profesionale dhe njohuritë e gjuhëve të huaja;
24. Deklarimin lidhur me gjendjen gjyqësore të drejtorit ekzekutiv, si dhe çdo punonjësi të punësuar.
25. Njësitë përbërëse të administratës së Agjencisë, kontratat e punës dhe niveli i pagave të tyre.
26. Deklaratë e gjendjes financiare aktuale të nënshkruar nga drejtuesi i Agjencisë.
27. Pasuritë e paluajtshme në emër të Agjencisë, të vërtetuara me certifikatë pronësie nga ZRPP-ja (kopje e noterizuar).
28. Performancën në lidhje me mbledhjen dhe shpërndarjen e shpërblimeve për anëtarët e saj.
29. Performancën në lidhje me shpenzimet e kryera në ushtrim të objektit të licencës.
30. Transparencën e bilanceve, informacionit dhe raportimit me organet e tjera shtetërore.
31. Paga e tarifës për aplikim për ripërtëritjen e licencës të organizatave, si agjenci të administrimit kolektiv, në përputhje me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 33, datë 18.1.2017, “Për miratimin e tarifave për shërbimet e ofruara nga Drejtoria për të Drejtën e Autorit”.
32. Procese gjyqësore me objekt cenimi të të drejtave të mbrojtura nga Agjencia.

Po _____ Jo _____

33. Nëse keni listoni dhe paraqisni bashkëlidhur kopje të vendimeve të gjykatës nga sekretaria gjyqësore:

Për Agjencinë e Administrimi Kolektiv

Emri, mbiemër, firmë, vulë, përfaqësuesit ligjor të Agjencisë

